

PIKËPAMJET E MARGARET HASLUCK-UT DHE EDITH DURHAM-IT PËR „KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT”

MARGARET HASLUCK AND EDITH DURHAM'S VIEWS ON THE "CANON OF LEKË DUKAGJINI"

Esmije VESELI

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filologjik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
esmiye.veseli@unite.edu.mk

Abstrakti

Kultura shqiptare në përgjithësi dhe tradita në veçanti, kanë qenë në qendër të vëmendjes së studiuesve të ndryshëm, qofshin ata shqiptarë apo të huaj. Qasja e tyre ndaj kulturës shqiptare transkriptohej qartë dhe interesi për t'i kanalizuar idetë e tyre dëshmon për vlerat e mirëfillta që zotëronte populli shqiptar ndër shekuj. Në këtë studim, duke u mbështetur në rëndësinë e dy emrave të përmendur që në titull do të mundohemi që ta zbërthejmë një të vërtetë të heshtur, e cila bëri që edhe studiuesit e ndryshëm ta thellonin dioptrinë e tyre në të vërtetën ekzistuese të popullit shqiptar, si dhe në të gjitha argumentet tjera të cilat flasin zëshëm për traditën shqiptare sipas kodit kanunor. Të gjitha këto botëkuptime, interpretime, dilema dhe krahasime në këtë punim kanë një nënvizim të veçantë me idenë që ta saktësojnë vendin dhe rëndësinë e “Kanunit të Lekë Dukagjinit” sipas këndvështrimit dhe vëmendjes së studiuesve të lartpërmendur.

Fjalët kyçe: këndvështrimi, Kanuni, krahasimi, ligji/kodi, tradita

Abstract

Albanian culture in general, and tradition in particular, have been at the center of attention of various scholars, whether they were Albanian or foreign. Their approach to Albanian culture was often transcribed in detail, and their interest in channeling their ideas shows the genuine values that the Albanian people have possessed through the centuries. In this study, based on the significance of the two names mentioned in the title, we will try to unpack a silent truth—one that even led various scholars to deepen their perspective on the existing reality of the Albanian people, as well as on all the other arguments that speak loudly about Albanian tradition according to the Kanun code. All these worldviews, interpretations, dilemmas, and comparisons in this paper carry a special emphasis on the idea of clarifying the place and importance of the “Kanun of Lekë Dukagjini”, according to the perspective and attention of the aforementioned scholars.

Keywords: Perspectives, The Kanun, Comparison, Law/Code, Tradition

Hyrja

“*Kanuni i Lekë Dukagjinit*”, simboli kryesor i funksionimit, rritjes dhe përbërjes së popullit shqiptar ka qenë gjithmonë në qendër të studimeve të ndryshme të studiuesve shqiptarë, apo të huaj, duke e parë zhvillimin dhe ruajtjen e tij në korniza të një shoqërie të vjetër, që lindej dhe jetonte vetëm nga ligjet/normat e veta. E tilla, duke u rritur në vetvete po aq sa të gjitha rritjet të cilat i visheshin shoqërisë njerëzore, arriti që ta krijonte jetën e vetes, duke e ngritur mbi bazat e ligjeve të ndryshme malësore, ligjeve të pashkruara, të cilat nuk mbetën vetëm në sytë e studiuesve shqiptarë, por edhe në interes vëzhgimi edhe të studiuesve të huaj. Ndaj, duke u njohur vlera e Kanunit, duke u menduar koha dhe hapësira në të cilën lindi dhe u krijua çdo normë e tij, është shumë e pranueshme që ashtu si çdo element i bukur dhe interesant që i përket një populli të huaj, vihet në pah dhe studiohet, edhe Kanuni i Lekës të ishte dhe të mbetet edhe

sot e kësaj dite në qendër dhe në interes të studiuesve të ndryshëm, me të gjitha pikat të cilat e karakterizojnë atë. Ja se si shprehen më poshtë dy studiueset e përzgjedhura:

Pikëpamjet e Margaret Hasluck-ut

Zonja e cila e tregoi fuqinë e saj femërore duke kontribuar fort në sferën e kulturës dhe traditës në përgjithësi, duke mos e lënë anash as kulturën dhe traditën e veçantë të popullit shqiptar ishte Margaret Hasluck. Ndonëse u ndodh nën tryshninë e mendësisë së ashpër të malësorëve të kohës, ajo arriti që t'i sistematizonte njohuritë themelore në librin e saj të titulluar “*Kanuni Shqiptar (Ligji i pashkruar shqiptar)*”. Zhvendosja e saj nga një realitet në një realitet tjetër (tërësisht të panjohur) nuk qe e lehtë, ngase ishte e vetëdijshme se përpara vetes do të kishte një hapësirë/terren të ashpër, por jo të pamundur për ta realizuar synimin dhe qëllimin e saj. Parë në këtë këndvështrim, ajo iu rek punës me shumë përkushtim për ta nxjerrë në dritë materialin e mbledhur nga përvojat e saj në fusha të ndryshme, edhe atë: në fushën e kulturës dhe traditës zakonore shqiptare. Kureshtja e Hasluck-ut shkoj përtej së vërtetës, realizoi një testament qindravjeçar (pa një datë konkrete se kur janë shkruar, përveç pohimit se këto ligje/norma/rregulla mund ta kenë zanafillën e tyre edhe nga Mesjeta e hershme) duke u kujdesur për formën dhe përmbajtjen e pasqyrimin të mendësisë shqiptare, që rronte dhe vepronte në zonat malore. Sigurisht që një studim i tillë kërkonte këmbëngulje, vullnet të madh dhe fuqi të pashterur, apo edhe kohë të kushtuar, sepse vështirësitë ishin të mëdha, siç mund të përmenden kushtet dhe rrethanat në të cilat dukeshin, jetonin dhe barteshin normat kanunore në këto vise shqiptare, në këto vise të cilat popullin shqiptar e vetëqeverisnin në çdo pikëpamje të tij. Pavarësisht sakrificës dhe rrezikut, Hasluck-u ia doli ta kurorëzonte punën e saj në një pjesë të caktuar dhe jo të plotë, ngase sëmundja vdekjeprurëse nuk e la që misioni i saj të shkonte deri në fund dhe ta shihte veprën e saj studimore të botuar, por jo të përfunduar si qëllim, sepse ishte e sigurt që porosinë e saj do ta çonte në vend mikja e saj, ngase edhe ajo e njihte Shqipërinë dhe kulturën shqiptare në përgjithësi. Gjithsesi, ajo për të cilën sot Hasluck-u ka një vend të sigurt në ciklin e studimeve të bëra për traditën dhe më tepër për “*Kanunin e Lekë Dukagjinit*” është përkushtimi dhe rrjedha e saj ndaj të gjitha informacioneve dhe dëshmimeve të koleksionuara vite me radhë.

Vëllimi i zonjës Hasluck përbën një kontribut të madh e të veçantë në morinë e studimeve me interes etnografik, sepse “*kryesisht, libri bën fjalë rreth të drejtës zakonore të malësisë. Po, e sheh këtë të drejtë, si mjet për të kuptuar bazat themelore ligjike të këtij kodi dhe zbatimin e tij në praktikë. Autorja, e shpjegon mënyrën e jetesës shqiptare me mjaft hollësi, duke dhënë herë pas here detaje, mbi çështje të veçanta të cilat pasqyrojnë funksionimin e së drejtës të pashkruar*”.¹ Libri i zonjës Hasluck fillon nga *Struktura gjeografike* e cila thekson se është i detyrueshëm një vështrim gjeografik dhe për më tepër një pasqyrim i përgjithshëm i situatave dhe politikave që sundonin në atë kohë, sepse studimi lidhej shumë me hapësirën dhe rrethanat në të cilat praktikoheshin logjika kanunore. Ajo ka dhënë hollësi mbi infrastrukturën e Shqipërisë dhe këtë e ka bërë në mënyrën më të mirë të mundshme, duke e ditur se zonja Hasluck ishte një njohëse e mirë e vendit, ngase aty i kishte kaluar 20 vjet (në Elbasan) të jetës së saj. Ajo, një rëndësi të madhe i kushtoi përshkrimit fizik “*sepse këto tipare kishin ndikuar shumë mbi formimin e grupimeve shoqërore. Dendësia e maleve të larta ka bërë që shqiptarët t'ia kushtojnë të njëjtën rëndësi, si blegtorisë, ashtu edhe bujqësisë*”.² Gjithashtu, përshkruan çdo hollësi apo çdo milje e lartësi bregdetare dhe malore që e karakterizonte Shqipërinë. Ndalon edhe në gjëra që janë tepër sipërfaqësore, por të rëndësishme, sidomos kur flet për të reshurat e shiut apo për klimën mesatare bregdetare të qyteteve dhe shumë hollësi të tjera që e ndërtojnë

¹ Margaret Hasluck, *Kanuni Shqiptar (Ligji i pashkruar shqiptar)*, f. 7

² Po aty, f. 12

kolazhin e vendit ku ajo punoi dhe e ndërtoi karrierën e saj. Kjo njohje kaq e theksuar e hapësirës shqiptare luajti një rol të rëndësishëm në punën dhe jetën e saj.

Në kapitullin e dytë e shpjegoi ligjin e pashkruar, kur u zhvillua dhe sa rëndësi kishte për shoqërinë që jetone dhe vepronte në ato zona malore, duke bërë me dije që *“ky ligj është hartuar nga malësorët në një kohë që s’mbahet mend, si pjesë e sistemit ligjor, të cilin e zhvilluan për çdo aspekt të jetës së tyre. Ata i zhvilluan gjithë ligjet e tyre shoqërore, administrative, apo pastoral-pa ndihmën e kërkujt”*.³ Këto të dhëna orientojnë drejt një të vërtete ekzistente, sidomos kur flet për kapacitetin dhe vendosmërinë e njerëzve që rronin të pavaruar dhe me një logjikë tërësisht ndryshe kur bëhej fjalë për sundimin e ligjit, se ligji ishte sundimtari i vetëm për të cilin mbanin llogari dhe e ndërtonin jetën e tyre. Organizimi dhe funksionimi i tyre në fise, ishte një tjetër dimension i rëndësishëm, në të cilat portreti i udhëheqësit e simbolizonte fuqinë e njeriut me status fuqiplotë të dekretuar nga vetë banorët. Ai e mbante kurorën autoritare duke e mbështetur fuqishëm kreun udhëheqës sepse ai i realizonte qëllimet dhe kërkesat që ia parashtronin fiset të cilësdo natyrë qofshin. Ai gëzonte një autoritet të plotë dhe statusi i tij ishte i palëkundur deri në momentin kur nuk e keqpërdorte detyrën dhe pozitën e tij. Në qoftë se ndodhte e kundërta atëherë masat ndëshkuese ishin të rrepta, aq më tepër kur i niseshin kreut udhëheqës, që ishte më i dalluari nga të gjithë pjesëtarët, qofshin ata të familjes, apo edhe më gjërë.

Një fakt tjetër që zonja Hasluck e ka theksuar është humbja e fuqisë së ligjislaturës civile, dikur i patrazuar dhe shumë domethënëse, e cila erdhi si rezultat i politikës dhe rrethanave të cilat ndikuan edhe në mendësinë e malësorëve për ta çrrënjësuar gradualisht ligjin e vjetër dhe për ta përshtatur me një ligj tërësisht të ndryshëm (me ligje evropiane) nga ai pari. Kodi civil, pas Pavarësisë kishte filluar të zbehej dhe kjo ishte e dukshme, edhe pse përpjekjet për ta zhdukur në tërësi nga skena kishin ekzistuar, por fatmirësisht mbijetoi dhe sot e kësaj dite llogaritet një vlerë e shtuar dhe e rëndësishme e gjithë popullit shqiptar. Në kapitujt tjerë e përshkruan në hollësi funksionimin dhe organizimin e familjeve shqiptare, të cilat dritë kryesore e kishin ligjin, ligj i cili i përfshinte të gjitha hapësirat shqiptare, duke filluar nga shtëpia shqiptare, nga i zoti i shtëpisë, ndarja e vëllezërve e deri te bajraktarët që ishin njerëzit më të përzgjedhur të fisit, sepse ata e kishin fuqinë ligjore dhe çdo urdhër i tyre ishte i padiskutueshëm në të gjitha çështjet, të cilësdo natyrë me të cilën shfaqej problemi.

Pikëpamjet e zonjës Hasluck dhanë një kontribut të madh mbi prejardhjen e shqiptarëve, vërtetuan teza mbi ekzistencën e ligjit të pashkruar, të ligjeve të Kanunit, trungut të popullit shqiptar, që ka kulturë, histori, gjuhë dhe mbi të gjitha një identitet në të gjitha pikëpamjet e tij. Të gjitha këto pika e dëshmojnë mjaft qartë jo vetëm mënyrën e jetesës së popullit në kohën e tillë, por edhe mënyrën se si ligjet, kultura, gjuha dhe çdo pikë tjetër e identitetit shqiptar arriti të bëhej pjesë e vështrimeve/studimeve të huaja.

Pikëpamjet e Edith Durham-it

Në qoftë se do të bëhej një përmbledhje e studimeve të ndryshme të cilat janë bërë për kulturën dhe kombin shqiptar, do të shiheshin mendime të larmishme, botëkuptime të ndryshme që flasin për një rëndësi të veçantë për sa i përket aspektit gjuhësor, historik, etnografik, tradicional etj. Ndër personalitetet e huaja që nxori në dritë shumë dëshmi të cilat e karakterizojnë profilin e popullit shqiptar, të lindur dhe të rritur thellë në malësinë e Shqipërisë, është padyshim mikja e shqiptarëve, studiuesja Edith Durham-i. Ajo nëpërmjet një udhëpërshkrimi përcjell elemente të lashta shqiptare, duke kontribuar mjaft për kulturën shqiptare në përgjithësi. Puna e saj për më tepër dëshmoi për figurën e një gruaje me vlera dhe energji të pashoqe për sa i përket mënyrës së qasjes ndaj një realiteti që asokohe mbretëronte në trojet shqiptare. Është për t’u admiruar personaliteti i saj, ngase bëri një punë të madhe për sa i përket edhe historisë shqiptare, sepse

³ Po aty, f. 19

me vetëdije të plotë e tregoi identitetin e plote të shumë figurave madhështore të kësaj historie, që ndoshta më parë gjendeshin të cunguara si informacione, apo dëshmi, e që sot e kanë kompletuar dosjen që lidhet me historinë, traditën, kulturën dhe gjithëcka tjetër që ka lidhje me mendësinë shqiptare.

Edith Durham-i solli dhe argumentoi të dhëna që ishin të lidhura ngushtë me historinë e popullit shqiptar, duke filluar nga prejardhja e Lekë së Madh, për të cilin u përmend se “*qe një maqedonas, dhe Olimpia, e ëma, qe një princeshë e Epirit (Shqipëria e Jugut); prandaj Aleksandri pa dyshim qe shqiptar*”.⁴, një figurë që i nënshtroheshin shumë popuj vetëm për ta përvetësuar. Pastaj shkroi me përkushtimin të madh edhe për figurën e Lekë Dukagjinit, për të cilin ndër të tjera u shpreh: “*Ndërkaq gjithë fiset e maleve të Shqipërisë e mbrojtën vetën. Lekë Dukagjini dhe vëllai i tij Pali mbetën të pavaruar në rrafshin midis Drinit dhe detit, ku fiset e tyre dhe të Mirditës rrojnë dhe sot të pazbutur, dhe qeverisen nga,, ligjet e pashkruara të maleve*”, që mbajnë emrin e Lekës dhe sot, por që besohet të kenë mbritur nga kohëra shumë të lashta dhe që është ligji ekzistues më i vjetri në Evropë”.⁵ dhe për shumë dukuri të tjera që ishin pjesë e të kaluarës historike, gjuhësore, etnografike etj., të shqiptarëve. Ndër të tjera ajo përmend figura të rëndësishme të historisë shqiptare, si: Gjergj Kastriot Skënderbeu, Moisi Golemin, si dy personalitete më aftësi të jashtëzakonshme e me fuqi të mbinatyrshme.

Në librat e saj shihet qartë një disponim i theksuar për ambientet ballkanike, për historitë e këtyre popujve që mundoheshin të kryesojnë me të bëmat dhe fuqinë e të fortit dhe të dobëtit, me preardhjen e tyre, me gjuhën, me traditën dhe gjithëcka tjetër në funksionin e të bërit popull dhe shtet. Është në interes të këtij punimi të theksohet fakti që Edith Durham-i nuk hezitoi t’i shfaqte edhe të metat dhe të vërtetat e dhimbshme të popujve ballkanikë, duke treguar në këtë mënyrë për karakterin e tyre në cilësinë e një gruaje të denjë e të vërtetë duke përcjellë emocion të papërsishkruar në suaza të së vërtetës bindëse dhe asaj sipërfaqësore, si dhe shumë karakteristika tjera që janë me mjaft interes për studiuesin shqiptar, apo atë të huaj. Në udhëpërshkrimin e saj vërehen dukshëm edhe elementet që lidhen me traditën zakonore shqiptare, pasi që iu dha mundësia që ta njohë për së afërmi natyrën e njerëzve të Malësisë që i bënin ballë çdo ligji dhe fuqie të ushtruar nga pushtimi turk. U mahniti shumë dhe ngeli e habitur nga fakti se si funksiononin këta njerëz, ku e gjenin gjithë atë vetëbesim, atë energji pozitive, ato rregulla e shumë pika tjera që lidheshin ngushtë me hapësirën e logjikën e tyre.

Ndër të tjera ajo e përmendi fisin, mikun, ligjin dhe pa se ligji i Kanunit ishte i pashmangshëm krahas ligjit turk apo ligjeve tjera. Ata çdo gjë e zgjidhnin sipas të drejtës zakonore dhe nuk lejonin asnjë ndërhyrje nga palë të cilat nuk thirreshin në emër të ligjit e aq më pak të përziheshin në rregullat dhe të drejta e tyre “*se ata ishin vetë të zotë për t’i dënua kriminelët dhe s’kishin nevojë për ndihmë nga Qeveria Turke. Unë u përpoqa që t’i bindja, por ata më thanë: „Ne i duam miqtë dhe jemi të kënaqur të të presim si mik. Ti mirëseerdhe këtu po deshe si mik, por në qoftë se ke në mend që të përzihesh në punët tona, ne dëshirojmë që të të njoftojmë se ti këtu je vetëm me katër gjendarmë, kurse ne jemi të gjithë të armatosur, pra jemi në gjendje të të themi të kthehesh mënjeherë nga ke ardhur, para se të jetë vonë!*” Edhe unë në atë mendje isha. Ata u sollën shumë të njerëzishëm, më gostitën më së miri me të ngrëna e të pira dhe më thanë mirupafshim”.⁶ Kjo situatë e bindi atë që këta njerëz ishin më të fortë se një ushtri që thirrej në emër të të fortit dhe se ligjet e tyre kundrejt ligjeve të Lekës dhe fuqisë së tyre administrative ishin shumë më të dobëta dhe se nuk përbënin asnjë rrezik për ta. Edhe pse të pashkolluar, “*nuk dinë as të shkruajnë dhe lexojnë, por kanë tru plot ta them unë, plot*”.⁷ Kjo bindje e dëshmoi statusin e tyre të pavaruar dhe se “*Leka Dukagjini duket se është një personalitet, imponent, që ka influencuar shumë në popull, aq sa dhe shprehja “kështu ka thënë Leka”, ka një forcë detyruese, më shumë se dhjetë komandamentet e Biblës, më shumë se*

⁴Edith Durham, Brenga e Ballkanasve, Tiranë, 2000, f. 20

⁵Po aty, f. 42

⁶Po aty, f. 217.

⁷Po aty, f. 217.

mësimet e Islamit dhe të krishterimit, më shumë se ligji i sheriatit dhe i Kishës, se të gjitha këto që i përmendëm, ishin të detyruar t'i nënshtroheshin Kanunit, të Lekë Dukagjinit. Fama e Lekës, ndërmjet fiseve malsore që e ruajnë me krenari dhe me nderë emrin e tij, se këto teritore e kanë kapërcyer edhe famën e Skenderbeut”⁸.

Përfundimi

Margaret Hasluck-u dhe Edith Durham-i bënë një punë madhështore, sidomos për shqiptarët sepse nxorën në pah elemente që datojnë shumë herët ngase mendohej, identifikuan të dhëna që u përkisnin shqiptarëve dhe të kalurës së tyre të lashtë dhe shumë situata të tjera që shpiejnë drejt një vërtetësie të pamohueshme mbi pozitën gjeografike të Shqipërisë së atëhershme sipas natyrshmërisë së saj. Duke i njohur veprat e tyre si dhe duke e parë rëndësinë e tyre të madhe gjatë kapërcimit të kohës, padyshim se të dyja janë ndër zërat më të dalluar, zërat që meritojnë më shumë respekt dhe mirënjohje nga gjithë shqiptarët, aq më tepër për punën e palodhshme e shembullore dhe për karakterin që treguan gjatë përshkrimit të ndodhive, ngjarjeve dhe gjithçkaje që ishte vënë në një kohë dhe hapësirë të duhur. Emrat e këtyllë janë një vlerë e madhe dhe e paharrueshme e historisë së popullit shqiptar, sepse arritën që në botën e huaj, në hapësirat larg një Shqipërie të vogël ta paraqisnin vlerën e saj të madhe, vlerën e saj të pashoqe në morinë/larminë e madhe të popujve të ndryshëm dhe te gjithë të tjerët ta bënin të njohur e ta (për)afrojnë Kanunin, simbolin kryesor të funksionimit të shoqërisë shqiptare të kohës, në një hapësirë të ruajtur nga vetja, po aq sa edhe nga Perëndia.

Referencat

- [1] Bandiđ, Dušan (1980): Tabu u tradicionalnoj kulturi srba. BIGZ. Beograd
- [2] Bardhoshi, Nebi (2011): Gurtë e kufinit. Kanuni, pronësia, strukturimi social. UET Press. Tiranë
- [3] Bardhoshi, Nebi (2014): Antropologji e kanunit. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit. Departamenti i Etnologjisë. Tiranë
- [4] Çetta, Anton (1978): Këngët e Kurt Mehmetit dhe Sadik Ramës të familjes Gjonbalaj nga Vuthaj. Gjurmime albanologjike. Folklor dhe etnologji. VI-1976. Instituti Albanologjik i Prishtinës
- [5] Çobani, Tonin (2003): Princi i përfolur Lekë Dukagjini. Listian&Toena. Tiranë. Dedaj, Ndue (2010): Kanuni mes kuptimit dhe keqkuptimit. GEER. Tiranë
- [6] Durham, Edith (1990): Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë
- [7] Elezi, Ismet (2002): E drejta zakonore e Labërisë. Botimet Toena. Tiranë
- [8] At Shtjefan Gjeçovi. Kanuni i Lekë Dukagjinit. O. F. M. Kuvendi. Tiranë. FSHEL (1966): Folklor shqiptar, II. Epika legjendare. Përgatitur nga Qemal Haxhihasani dhe Zihni Sako. Instituti i Folklorit. Tiranë
- [9] Hahn, Georg, Johan (2008): Studime shqiptare. Instituti i Dialogut & Komunikimit. Tiranë
- [10] Hasluck, Margaret (2005): Kanuni (Ligji i pashkruar shqiptar). Bleu I. Lisitan. Tiranë
- [11] Hoxha, Izet (1987): Një paralelizëm midis kanunit të Lekë Dukagjinit, zakonit të car Stefan Dushanit dhe të drejtës bizantine. Etnografia shqiptare. 15. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë
- [12] Kasteleti, Xhuzep (2012): Normat zakonore dhe jeta shoqërore në malësitë shqiptare, sipas kanunit të Lekë Dukagjinit. Studi Albanesi, 3-4. Romë, 1933. OMBRA GVG. Tiranë
- [13] Lutfi Alia, Kanuni - Kodi i së drejtës zakonore (8), Itali, 2012, f. 106.
- [14] Murtezani, Izaim (2014): Refleksione etnokulturore. Shkup
- [15] Vata, Roven (2012): Miti i malit në kanunin e Lekë Dukagjinit. Gjurmime albanologjike. Folklor dhe etnologji. Nr. 41-42/2011-2012. Instituti Albanologjik. Prishtinë.

⁸ Lutfi Alia, Kanuni - Kodi i së drejtës zakonore (8), Itali, 2012, f. 106.